

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6170  
E premte, 20 nëntor 2020  
çmimi 0.40

## Mbi 12 000 raste aktive me Covid në Kosovë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

BEHGJET PACOLLI I SHKRUAN LETËR KRYEMINISTRIT TË SHQIPËRISË, EDI RAMA

## PACOLLI KËRKON NDIHMËN E SHQIPËRISË PËR TA KUNDËRSHTUAR RAPORTIN E DICK MARTYT



Kryetari i Aleancës Kosova e re (AKR), njëherësh deputet i Kuvendit të Kosovës, Behgjet Pacolli, nëpërmjet një letre dërguar kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, ka kërkuar ndihmën e shtetit të Shqipërisë për të nisur një përpjekje të gjerë kombëtare për ta kundërshtuar në mënyrë diplomatike raportin Dick

Martyt. Në këtë letër Pacolli ka thënë se Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë së bashku duhet ta udhëheqin një fushatë informuese dhe diplomatike rreth mosndëshkueshmërisë së thellë të krimeve të luftës që Serbia ka kryer në Kosovë. "Na duhen veprime diplomatike

të drejtuara nga Shqipëria, që do të kundërshtojnë raportin e trilluar të Dick Martyt në Këshillin e Evropës, gjithashtu të adresohen kërkesat për hetimin e krimeve të luftës që Serbia ka kryer në Kosovë, më e rëndësishmja fshehja e trupave të personave të zhdukur", ka thënë Pacolli

## POZITA DHE OPOZITA 'PËRPLASEN' ME FJALË PËR TË PAGJETURIT, PËR PAK EDHE FIZIKISHT



Deputetët e Kuvendit të Kosovës për disa orë kanë diskutuar të enjten në lidhje me çështjen e të pagjeturve. Në interpelancën parlamentare për këtë çështje, në të cilën ka qenë i ftuar kryeministri Avdullah Hoti, ky i fundit është "përplasur" verbalisht me nënkryetaren e Kuvendit, Arbërie Nagavci, e cila e ka akuzuar shefin e

qeverisë se me marrëveshjen e Uashingtonit ka barazuar të pagjeturit me të zhvendosurit. Ballafaqimet verbale në mes të pozitës dhe të opozitës nuk janë ndalur gjatë gjithë kësaj interpelance, në fund të së cilës gati sa nuk ka ndodhur një përleshje fizike në mes të deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosjes dhe të LDK-së

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk) Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
-NDËRTIM  
-PROJEKTIM  
-SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE

**KOSOVA NUK PËRFAQËSOHET NGA UNMIK-u NË TRAKTATIN E KOMUNITETIT TË ENERGJISË** F.7

**KOMF-I, QEVERISË: STREHIMORET PËR FËMIJË RREZIKOJNË TË MBYLLEN NË JANAR** F.6

**MAQEDONIA E VERIUT DO TË SHPALLË GJENDJE KRIZE PËR PËRBALLJE ME PANDEMËN** F.2

**PROJEKTIGJI PËR GJYKATËN KOMERCIALE DREJT FINALIZIMIT** F.7

### EKONOMI



**EKZEKUTOHET NDIHMA FINANCIARE PREJ 1 MILION EUROSH PËR "TREPÇËN"** F.9

**MINISTRI REÇICA NË PËRKRAHJE TË PUNËKËRKUESVE PËR HAPJEN E BIZNESEVE TË REJA** F.8

### SPORT



**'DARDANËT' NË KARANTINË** F.14

# Gjykata në Beograd ka urdhëruar zhvarrosjen e mbetjeve mortore pranë Rashkës

BEOGRAD, 19 NËNTOR- Departamenti i Krimeve të Luftës i Gjykatës së Lartë në Beograd, më 18 nëntor, ka lëshuar një urdhër për zhvarrosjen e një numri të paidentifikuar kufomash në një varrezë masive në Krizhevak të Komunës së Rashkës. Kjo u konfirmua për "Radion Evropa e Lirë" nga Gjykata e Lartë. Sipas përgjigjes, fillimi i zhvarrosjes do të përcaktohet më vonë, ashtu si edhe komisioni që do të kryejë zhvarrosjen. "Gjithashtu, është caktuar një ekspert gjyqësor, i cili do të mbledhë dhe sigurojë gjurmë materiale që janë gjetur në vend gjatë hetimit paraprak, në përputhje me raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MUP) të Serbisë", ka njoftuar gjykata.

Sipas kësaj gjykate, Ministria e Brendshme është udhëzuar të bëjë sigurimin në mënyrë

adekuate të lokacionit, ndërsa veprimet tjera të rëndësishme do të përcaktohen me një urdhër shtesë që do të lëshohet më vonë, duke pasur parasysh kushtet aktuale të motit, periudhën e vitit dhe mungesën e të dhënave të hollësishme. Prokuroria e Krimeve të Luftës në Beograd ka njoftuar se më 17 nëntor se ishte në dijeni të informacionit se, në një lokacion afër Rashkës janë gjetur mbetje mortore, për të cilat dyshohet se janë të viktimave shqiptare nga Kosova dhe se "procedura po kalon në procedurë të Departamentit për Krime të Luftës në Gjykatën e Lartë të Beogradit". Më 16 nëntor, drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, Arsim Gërxhaliu, pati konfirmuar për "REL" se në varrezën masive në Krizhevak dyshohet se gjenden mbetjet mortore të shqiptarëve të Kosovës.



## Maqedonia e Veriut do të shpallë gjendje krize për përballje me pandeminë



SHKUP, 19 NËNTOR- Këshilli i Sigurisë Kombëtare i Maqedonisë së Veriut e ka vlerësuar si mjaft serioze gjendjen me pandeminë në vend, andaj edhe i ka propozuar qeverisë miratimin e vendimit për shpalljen e gjendjes së krizës në gjithë territorin e vendit në kohë kohëzgjatje prej 30 ditëve. Nëse vendimi miratohet, në përballje me pandeminë do të përfshihen edhe Armata e

Maqedonisë së Veriut, ndërsa qeveria do të mund të administrojë edhe me spitalet private dhe me kapacitetet tjera për përballje sa më efektive me koronavirusin e ri që shkakton sëmundjen Covid-19. Shpallja e gjendjes së krizës nuk nënkupton edhe aplikim të orës policore. "Më së voni të premtën në mbrëmje do të mbajmë mbledhjen e qeverisë dhe nëse kryhen të gjitha aspektet formale juridike, ne

do të miratojmë vendimin. Nuk përjashtohet edhe masa tjera, si orë policore, por këtë për momentin e nuk e kemi paraparë. Mbetet rekomandimi për të mos u grumbulluar pas orës 22.00 dhe respektimin e të gjitha masave tjera që janë në fuqi", ka deklaruar kryeministri Zoran Zaev pas mbledhjes së Këshillit të Sigurisë që drejtohet nga presidenti Stevo Pendarovski.

## "Facebook" akuzohet se i detyroi punëtorët të kthehen në zyrë gjatë pandemisë

Më shumë se 200 mbikëqyrës të përmbajtjes në "Facebook", nga e gjithë bota, e kanë akuzuar kompaninë se i detyroi ata të ktheheshin në zyrë gjatë pandemisë, dhe kërkuar mbrojtje më të mirë të shëndetit dhe siguri.

Ata përgatitën një peticion, në të cilin thanë se "Facebook" "po rrezikonte pa nevojë" për të siguruar fitime. Punëtorët

kërkuar që gjiganti i medieve sociale të garantojë kushte më të mira, ose t'i lejojë punëtorët të vazhdojnë punën e tyre nga shtëpia. Në gusht, "Facebook"-u ka njoftuar që personeli do të lejohej të punonte nga shtëpia deri në verën e vitit 2021. Por, kompania mbështetet në mijëra kontraktorë për t'i zbuluar postimet e padëshiruara. "Pas disa muajsh lejimi të



mbikëqyrësve të përmbajtjes për të punuar nga shtëpia, përballë një presioni të fuqishëm për të mbajtur 'Facebook'-un pa urrejtje dhe

dezinformim, ju na keni detyruar të kthehemi në zyrë", thuhet në letrën e hapur të lëshuar nga firma "Foxglove" e aktivistëve ligjorë me bazë në Britani. "Ne i vlerësojmë mbikëqyrësit e përmbajtjes dhe ne i japim përparësi shëndetit dhe sigurisë së tyre", tha një zëdhënës i "Facebook"-ut. Kontraktorët thanë se thirrja për t'u kthyer në zyrë kishte ardhur

pasi kishin dështuar përpjekjet për t'u mbështetur më shumë në Inteligjencën Artificiale (AI) në identifikimin e përmbajtjes problematike. "Facebook-u ka nevojë për ne. Është koha që ju ta pranoni këtë dhe të vlerësoni punën tonë. Të sakrifikojmë shëndetin dhe sigurinë tonë për përfitim është e pamoralshme", kanë thënë punëtorët e "Facebook" në ankesën e tyre.

## BE-ja: Azerbajxhani dhe Armenia të ruajnë armëpushimin

BRUKSEL, 19 NËNTOR- Bashkimi Evropian e ka mirëpritur përfundimin e luftimeve ndërmjet Azerbajxhanit dhe Armenisë për rajonin e shkëputur të Nagorno Karabakut. BE-ja u ka bërë thirrje të dyja palëve, të

respektojnë në mënyrë rigoroze marrëveshjen e paqes të ndërmjetësuar nga ana e Rusisë, në mënyrë që të parandalojnë pasojat në njerëz. Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell përmes një

deklarate të lëshuar të enjten, nxitu "të gjithë aktorët në rajon të përmbahen nga çdo veprim ose retorikë" që mund të rrezikojë armëpushimin. Marrëveshja e paqes u arrit pasi forcat azerbajxhanase bënë përparime të mëdha në fushën e betejës,

pas gjashtë javë luftimesh, duke rifituar territorin e humbur gati tre dekada më parë.

Marrëveshja lejon Azerbajxhanin të mbajë një pjesë të konsiderueshme të rajonit malor, si dhe të pjesëve përreth. Në bazë të



marrëveshjes, rreth 2 000 paqeruajtës rusë do të vendosen në rajon për një periudhë pesëvjeçare.

# Pozita dhe opozita “përplasen” me fjalë për të pagjeturit, për pak edhe fizikisht

Deputetët e Kuvendit të Kosovës për disa orë kanë diskutuar të enjten në lidhje me çështjen e të pagjeturve. Në interpelancën parlamentare për këtë çështje, në të cilën ka qenë i ftuar kryeministri Avdullah Hoti, ky i fundit është “përplasur” verbalisht me nënkryetaren e Kuvendit, Arbërie Nagavci, e cila e ka akuzuar shefin e qeverisë se me marrëveshjen e Uashingtonit ka barazuar të pagjeturit me të zhvendosurit. Ballafaqimet verbale në mes të pozitës dhe të opozitës nuk janë ndalur gjatë gjithë kësaj interpelance, në fund të së cilës gati sa nuk ka ndodhur një përleshje fizike në mes të deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosjes dhe të LDK-së

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, është kritikuar në Kuvend nga opozita për përfshirjen e çështjes së të pagjeturve në marrëveshjen e Uashingtonit pasi, sipas saj, “kjo çështje është kushtëzuar me kthimin e personave të zhvendosur”. “Në të njëjtin paragraf, ku kaq keq trajtohet tema e të pagjeturve, është vendosur tema e të zhvendosurve dhe e refugjatëve, madje këta cilësohen të zhvendosur përbrenda duke barazuar dy kategori që nuk mund të barazohen. Kjo formë e trajtimit

të të zhdukurve e dëmton shumë procesin dhe kjo nuk është mënyra se si dialogohet”, ka thënë propozuesja e interpelancës parlamentare për çështjen e të pagjeturve, deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Saranda Bogujevci. Kryeministri Hoti është kundërpërgjigjur duke thënë se pyetja e parashtruar në interpelancë është plotësisht e pabazë, sepse askund nuk përdoret termi kushtëzim. “Këtë term nuk mund ta gjeni në tekstin e marrëveshjes ose zotimeve dhe as në planin e zbatimit të marrëveshjes. Nuk bëhet fjalë për asnjë lloj kushtëzimi të këtyre çështjeve”,

ka thënë Hoti. Më tutje, Hoti ka thënë se nuk do të ketë marrëveshje përfundimtare me Serbinë pa përfshirjen në këtë marrëveshje të çështjes së të pagjeturve dhe të zhdukurve. Ai, po ashtu, e ndërliði gjetjen e fundit të mbetjeve mortore në Kizhevak të Serbisë, me zotimet e marra nga Uashington nga Serbia. Tri orë të interpelancës janë karakterizuar me debat të ashpër që kaloi edhe në ofendime. Nënkyetarja e Kuvendit nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, e ka kritikuar kryeministrin Hoti për, siç ka thënë, “barazimin e viktimave shqiptare me të zhvendosurit”.

Ky fjalim ka nxitur reagimin e kryeministrin Hoti, i cili e ka vlerësuar atë “një ndër fjalimet më të liga në këtë Kuvend, prej se jam këtu deputet apo ministër përpara juve”. Pas kësaj ka reaguar Nagavci, duke e cilësuar “të lig dhe të dëmshëm nënshkrimin që kryeministri ka bërë në Uashington”. Më pas, kryeministri Hoti e ka lënë interpelancën, për t’u kthyer në qeveri ku, sipas zëvendëskryeministrin Driton Selmanaj, kishte një bisedë virtuale me presidentin francez Emmanuel Macron. Por, një veprim i tillë ka acaruar edhe më shumë deputetët opozitarë. Uran Ismaili nga Partia Demokratike e Kosovës ka deklaruar se kryeministri “nuk po ka guxim që të merret me këtë çështje”. “Çfarë ofensive diplomatike kemi filluar. Në Serbi janë gjetur eshtra të shqiptarëve. Mungesa e kryeministrin është neveritëse. Është dashur ta anulojë ose ta shtyjë këtë interpelancë”, ka thënë Ismaili. Zëvendëskryeministri Selmanaj ka thënë se qeveria nuk po i ikën përgjegjësisë, pasi për këtë

çështje ka raportuar në vazhdimësi. “Diçka që nuk e keni bërë ju për dhjetë vjet, mos pritni që për pesë muaj ta bëjmë ne”, ka thënë ai. Pas secilit fjalim të opozitës, shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka reaguar duke thënë se “duhet t’ju vijë marre për shfrytëzimin e kësaj teme për qëllime politike”. Njëjtë ka vepruar edhe zëvendëskryeministri Selmanaj. Debati ka eskaluar sërish në kohën kur në foltore është paraqitur me fjalimin përfundimtar deputetja Saranda Bogujevci, që e ka thirrur këtë interpelancë. Ky fjalim është ndërprerë, pasi nga vendet e tyre, deputeti i LDK-së, Arben Gashi dhe deputetja Mimoza Kusari-Lila u përfshinë në një debat për atë se kush duhet të ndihet i turpëruar. Interpelanca është ndërprerë pasi shumica e deputetëve janë ngritur në këmbë, duke mbrojtur qëndrimet e tyre me debate jashtë foltore, kurse skena në Kuvend është shndërruar edhe në tentim për përplasje fizike.



## KDI-ja kërkon të ndërmerren masa disiplinore ndaj deputetëve me sjellje joparlamentare

PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka theksuar se është duke i përcjellë më shumë shqetësim degradimin e mospajtimeve mes deputetëve të subjekteve politike parlamentare deri në përplasje verbale ndërmjet tyre. Me këtë

rast, KDI-ja ka dënuar sjelljet joparlamentare në seancën e sotme, gjegjësisht konfrontimet verbale në mes të deputetëve të LDK-së dhe LV-së gjatë interpelancës e cila shtjellonte një temë aq të ndjeshme për qytetarin e Kosovës siç është çështja e të

pagjeturve. “Përveç se janë të papranueshme, këto sjellje cenojnë vlerat themelore të demokracisë të cilat do të duhej t’i promovonte Kuvendi si organi më i lartë përfaqësues në vend. Ne ia rikujtojmë Kuvendit se ai duhet të shërbej si arenë e

diskutimeve përmbajtjesore drejt gjetjes së zgjidhjeve të problemeve të qytetarëve, e jo hapësirë që promovon sjellje e gjuhë joparlamentare që nuk gjenerojnë asgjë tjetër përveç se polarizim të mëtejshëm shoqëror dhe thellim të krizës politike. KDI kërkon që në

përputhje me Rregulloren të merren masa disiplinore ndaj deputetëve që penguan seancën e sotme kurse nga Kryesuesja e seancës të garantojë mbarëvajtjen e vazhdimin të seancës sipas Rregullores së Kuvendit”, është thënë në reagimin e KDI-së.



BEHGJET PACOLLI I SHKRUAN LETËR KRYEMINISTRIT TË SHQIPËRISË, EDI RAMA

# PACOLLI KËRKON NDIHMËN E SHQIPËRISË PËR TA KUNDËRSHTUAR RAPORTIN E DICK MARTYT

Kryetari i Aleancës Kosova e re (AKR), njëherësh deputet i Kuvendit të Kosovës, Behgjet Pacolli, nëpërmjet një letre dërguar kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, ka kërkuar ndihmën e shtetit të Shqipërisë për të nisur një përpjekje të gjerë kombëtare për ta kundërshtuar në mënyrë diplomatike raportin Dick Martyt. Në këtë letër Pacolli ka thënë se Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë së bashku duhet ta udhëheqin një fushatë informuese dhe diplomatike rreth mosndëshkueshmërisë së thellë të krimeve të luftës që Serbia ka kryer në Kosovë. “Na duhen veprime diplomatike të drejtuara nga Shqipëria, që do të kundërshtojnë raportin e trilluar të Dick Martyt në Këshillin e Evropës, gjithashtu të adresohen kërkesat për hetimin e krimeve të luftës që Serbia ka kryer në Kosovë, më e rëndësishmja fshehja e trupave të personave të zhdukur”, ka thënë Pacolli

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Kryetari i Aleancës Kosova e re (AKR), njëherësh deputet i Kuvendit të Kosovës, Behgjet Pacolli, i ka dërguar një letër kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, nga i cili ka kërkuar të drejtë një përpjekje të gjerë kombëtare për të kundërshtuar në mënyrë diplomatike raportin e Dick Martyt. Në këtë letër Pacolli ka thënë se Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë së bashku duhet të udhëheqin një fushatë informuese dhe diplomatike rreth mosndëshkueshmërisë së thellë të krimeve të luftës që Serbia ka kryer në Kosovë. “Dick Marty ishte rezultat i një dezinformimi

dhe fushate politike të sponsorizuar nga Rusia dhe Serbia për t'i sulmuar pavarësinë e Kosovës dhe UÇK-në. Aktakuza kundër presidentit Thaçi dhe të tjerëve nuk kishte përfshirë ndonjë pjesë nga raporti i Dick Marty, kështu që ky raport përmes një institucioni gjyqësor është hedhur poshtë dhe kjo tregon se raporti ka qenë vetëm një mjet politik nga Rusia dhe Serbia për ta sulmuar Kosovën. Kjo kërkon një sfidim nga brenda Këshillit të Evropës (aty ku Shqipëria është anëtare) nga ku ka dalë raporti i Dick Martyt. Na duhen veprime diplomatike të drejtuara nga Shqipëria, që do ta kundërshtojnë raportin e trilluar të Dick Martyt në Këshillin e Evropës, gjithashtu

do t'i adresonin kërkesat për hetimin e krimeve të luftës që Serbia ka kryer në Kosovë, më e rëndësishmja fshehja e trupave të personave të zhdukur”, ka thënë Pacolli, duke shtuar se kombi ynë, historia jonë dhe lufta jonë për çlirim dhe pavarësi është nën sulm. “Së bashku dhe të unifikuar duhet të përgjigemi. Ne nuk mund të pranojmë se një gjykatë e krijuar nga Kuvendi i Kosovës t'u ofrojnë amnisti krimeve të luftës që Serbia ka kryer në Kosovë dhe për ta ndryshuar rrëfimin historik të vendit tonë sipas gjuhës e mendësisë së prokurorëve serbë. Ne kemi krijuar institucionet që duhet të merren me drejtësinë, por drejtësia në Hagë po tradhton popullin e Kosovës, po përpjet

ta japë amnistinë e krimeve serbe të luftës në Kosovë dhe po ndryshon pozicionin e viktimës me agresor. Ne nuk mund ta tolerojmë këtë. Ne duhet të veprojme”, ka thënë Pacolli në këtë letër drejtuar kryeministrit Edi Rama.

Në konferencën statusore apo të ecurisë së çështjes pranë Dhomave të Specializuara në Hagë, e cila u mbajt të mërkurën, mbrojtja e Hashim Thaçit, e Kadri Veselit, e Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit ka kërkuar që gjykimi nën akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të nisë jo më herët se në verën e vitit 2022. Gjatë kësaj seance mbrojtja ka paralajmëruar se do të kërkojnë lirim me kusht për klientët e tyre.

Kundër ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-krerut të PDK-së, Kadri Veseli, deputetit dhe ish-anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Rexhep Selimi dhe ish-zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi, është konfirmuar aktakuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Të gjithë aktualisht gjenden në paraburgim në Hagë dhe janë deklaruar të pafajshëm.

Avokati mbrojtës i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, David Hooper dhe ai i ish-kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, Ben Emmerson, thanë se u duhen të paktën 18 muaj që të kryejnë hetime, në mënyrë që ta përgatitin mbrojtjen. Emmerson ka theksuar se mendon se gjykimi mund të zgjasë deri në dy vjet.

Hooper, po ashtu, e quajti “absurd” pretendimin e Zyrës së

Prokurorit të Specializuar që gjykimi të nisë në qershor të vitit 2021. Ai ka thënë se mbrojtjes i duhet që të ketë qasje në një aktakuzë që ka shkallë më të vogël të redaktimit dhe që materiali duhet të jetë i hapur për mbrojtjen.

Avokatja mbrojtëse e Jakup Krasniqit, Venkateswari Alagendra, dhe ai i Rexhep Selimit, David Young, thanë se u duhet kohë e mjaftueshme që të mund të kryejnë hetime të thella.

Sipas një parashtrere të Prokurorit të Specializuar dërguar Dhomave të Specializuara për këtë konferencë, e të publikuar në faqen e tyre të internetit, Prokuroria pretendon se për konfirmimin e aktakuzës ka disponuar material rreth 43 mijë faqe, duke përfshirë raporte, deklarata të dëshmitarëve, fotografi, mbi 20 orë material audio-vizual.

Prokuroria thotë se mbrojtjes parashikon t'i dorëzojë provat siç janë raportet, fotografitë, dokumentet e UÇK-së, duke përfshirë urdhrat, rregulloret etj. Prokuroria pretendon se lënda e saj disponon gati 100 000 prova. Edhe avokati i Veselit, Ben Emmerson, ka theksuar se nuk ka arsye që Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi të mbeten në paraburgim, duke shtuar se nuk ekziston rreziku i arratisjes së tyre por, sipas tij, prokuroria pretendon se të pandehurit kanë bërë “ndërhyrje në rregullin e drejtësisë”. “Prokuroria duhet të tregojë se pse këta katër të akuzuar duhet të qëndrojnë në burg”, ka thënë ai.

Duke komentuar aktakuzën, avokati i Veselit, Ben Emmerson, ka thënë: “Nuk ka ekzistuar ndërmarrje e përbashkët

kriminale ashtu siç përcaktohet në aktakuzë dhe nuk ka baza të tjera ligjore për ta quajtur zotin Veseli përgjegjës për aktet kriminale të të tjerëve”.

Avokati Emmerson ka shtuar se UÇK-ja ishte një lëvizje dhe kryengritje popullore spontane, “e organizuar në mënyrë minimale për ta mbrojtur popullatën civile nga gjenocidi dhe kriminelët serbë”. “Më shumë se 10 000 civilë shqiptarë janë vrarë nga forcat serbe, në masakra të planifikuara dhe vendi u përfshi nga kaosi dhe nga dhuna. Shqiptarët u varrosën në varre masive nga forcat serbe dhe shumë pastaj u zhvarrosën dhe ka shumë të tjerë që trupat e tyre gjenden në Serbi dhe janë fshehur atje”, ka thënë ai. Sipas Emmersonit, aktakuza e prokurorisë mund të ketë edhe prova “false”. “Aktakuza e prokurorisë është ndërthurur me arna, janë bashkuar disa akuza të ndryshme, nga zona të ndryshme të Kosovës, janë përmendur shumë emra njerëzish dhe njerëz të ndryshëm që pretendojnë se kanë qenë anëtarë të UÇK-së, kanë sajuar të gjitha këto akuza dhe janë bashkuar të gjitha në këtë ndërmarrje të përbashkët kriminale që paraqet prokuroria. Përvoja e mëparshme e Tribunalit për ish-Jugosllavi ka treguar se mund të ketë prova false që janë paraqitur në shumë raste nga prokuroria. Ndoshta prokuroria nuk e ka ditur se ato janë false, megjithatë ne duhet të bëjmë një ekzaminim të provave që paraqet prokuroria”, ka thënë ai.

Në fund të konferencës statusore, gjykatësi njoftoi se seanca e radhës do të mbahet në mesin e muajit dhjetor.



BEHGJET PACOLLI  
Third President of the Republic of Kosovo

Prishtinë, 16.11.2020

Sh.T.Z. Edi Rama  
Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

Inderuar Kryeministër Rama,

Unë po ju shkruaj në lidhje zhvillimet e fundit në Republikën e Kosovës me aktakuzën nga Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës ndaj Presidentit Z. Hashim Thaçi, liderit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) Z. Kadri Veseli, Ish-Kryetarit të Kuvendit të Kosovës Z. Jakup Krasniqi dhe Shefit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! Z. Rexhep Selimi, për gjoja se kanë kryer krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në pozitën e tyre udhëheqëse në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Aktakuza e prokurorisë të Hagës ndaj Hashim Thaçit dhe të ish-zyrtarëve të tjerë të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës shtrembëron historinë dhe heq në mënyrë selektive fakte duke bërë që çështja të jetë e njëanshme.

Kjo aktakuzë përshkruan një luftë në të cilën çdo veprim i forcave serbe të sigurisë ishte një operacion i drejtpërdrejtë kundër kryengritjes. Kjo është në fakt e pavërtetë, pasi masakrat, përdhunimet dhe shpërnguljet ndodhën edhe atje ku nuk kishte asnjë UÇK aktive. Kur kishte, përgjigjja ishte disproporcionale.

Gjykata Speciale u krijua pas raportit të dyshimit dhe politikisht dhe moralisht të korruptuar të përgatitur nga Senatori Zviceran Dick Marty në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Mandati i Gjykatës ishte qartë mbi pretendimet që Dick Marty ngre në raportin e tij, por Gjykata në aktakuzën e saj nuk është marrë aspak me pretendimet që Dick Marty i ka sajuar në raportin e tij.

Në dhjetor të vitit 2010, deputeti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dick Marty, ka publikuar një raport 30 faqesh, në të cilin pretendohet për kryerjen e krimeve të luftës kundër popullsisë civile nga ana e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gjatë luftës në Kosovë.

Raporti i Martyt mori nxitje nga spekulimet e ish-kryeprokurores së Gjyqit të Hagës, Carla del Ponte dhe dyshimet e ngritura në librin e saj të vitit 2008. Në të vërtetë, menjëherë pas qershorit të vitit 1999 dhe pas tërheqjes së trupave ushtarake serbe nga Kosova, Serbia e filloi një luftë agresive speciale, qëllimi i të cilës ishte diskreditimi i përpjekjes çlirimtare të shqiptarëve.

Në arenën ndërkombëtare, këto pretendime u shtyn përpara nga aleati kryesor gjeopolitik i Serbisë, që është Rusia. Në Dumen Ruse, kërkohet përdjekja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për trafikim të organeve. Në të njëjtën kohë është e habitshme dhe po aq zhgënjuese se si një propagandë kaq e qartë kundër UÇK-së, me kaq lehtësi u pranua si fakt i kryer nga miqtë tanë të proklamuar ndërkombëtarë.

Dick Marty ishte rezultat i një dezinformimi dhe fushatë politike të sponsorizuar nga Rusia dhe Serbia për të sulmuar pavarësinë e Kosovës dhe UÇK-në. Raporti i Dick Marty ishte një raport i inicuar nga Kryetari i Komisionit për Marrëdhëniet me Jashtë të Parlamentit Rus, Konstantin Kosachev në Prill 2008 menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Më përgjithësisht - dhe ndoshta më e rëndësishmja - Raporti i Dick Marty dhe niveli i Rezolutës së Këshillit të Evropës paraqiten sulme raciste ndaj popullit të Kosovës dhe drejtuesve të tyre politikë, duke sugjeruar një strukturë të shoqërisë që është e rrenjësuar në krim e lidhur me kulturën “klanore”.

Drejtësia duhet ta mishërojë dhe ta pasqyrojë të vërtetën historike, e jo ta shtrembërojë të vërtetën historike. Drejtësia është pjesë thelbësore e të vërtetës historike. Sot, ne po rrezikojmë të humbasim drejtësinë historike dhe narrativën tonë historike.

Në dritën e këtyre zhvillimeve, është e rëndësishme që Republika e Shqipërisë të drejtojë një fushatë diplomatike në Këshillin e Evropës për të kërkuar hetime mbi raportin e Dick Martyt.

Na duhen veprime diplomatike të drejtuara nga Shqipëria, që do të kundërshtojnë raportin e trilluar të Dick Marty në Këshillin e Evropës, por gjithashtu do të adresojnë kërkesat për hetimin e krimeve të luftës që Serbia ka kryer në Kosovë, më e rëndësishmja fshheja e trupave të personave të zhdukur.

Unë do të doja të ofroja ndihmën time të plotë në këtë betejë të rëndësishme për kombin tonë. Kur bëhet fjalë për luftën për çlirim dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ne duhet të qëndrojmë të bashkuar.

Sinqerisht i juaji,  
Behgjet Pacolli

# HOTI E MACRONI PAJTOHEN PËR ORGANIZIMIN E TAKIMIT TË NIVELIT TË LARTË PËR DIALOGUN

PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER)- Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka zhvilluar një takim virtual të enjten me presidentin e Francës, Emmanuel Macron, me të cilin ka biseduar për situatën e krijuar pas ngritjes së aktakuzave të para nga Dhomat e Specializuara të Kosovës si dhe procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën.

Në njoftimin e zyrës së kryeministrit Hoti, është thënë se Macroni ka vlerësuar reagimin institucional dhe të qytetarëve të Kosovës pas arrestimit të ish-krerëve të UÇK-së nga Dhomat e Specializuara të Kosovës. Ndërkohë sa i takon procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën, në njoftim është thënë se “kryeministri Hoti dhe presi-

denti Macron, u dakorduan që ditëve në vijim, si pjesë e mekanizmave për verifikim, të zhvillohen takime në nivel të ekspertëve që do të pasoheshin me takimin në nivel politik midis ministrave të brendshëm të të dyja vendeve”.

Hoti dhe Macroni kanë biseduar edhe për procesin e dialogut Kosovë-Serbi, për arritjen e marrëveshjes përfundimtare, me njohe reciproke, në kufijtë aktual. Ata janë pajtuar që të organizohet edhe një takim i nivelit të lartë rreth ecurisë së procesit të dialogut.

Zyra e kryeministrit Hoti ka njoftuar se presidenti Macron, i është përgjigjur pozitivisht ftesës së kryeministrit për vizituar Kosovën.



# KOMF-i, Qeverisë: Strehimoret për fëmijë rrezikojnë të mbyllen në janar

**EPOKA E RE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 NËNTOR- Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF, në prag të Ditës Ndërkombëtare të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, përmes një kërkesë zyrtare i është drejtuar kryeministrit Avdullah Hoti, ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica dhe ministres së Financave, Hykmete Bajrami, duke kërkuar ndërmarrjen e masave të menjëhershme për parandalimin e mbylljes së shërbimeve për fëmijët në nevojë si dhe zgjidhjen afatgjatë të financimit të shërbimeve sociale. "KOMF ka kërkuar: Ndërmarrjen e masave të menjëhershme për parandalimin e mbylljes së përkohshme të shërbimeve të strehimoreve për fëmijët pa përkujdes prindëror, viktimat të dhunës dhe abuzimit, viktimat të trafikimit (niveli i ulët i rrezikut) në Janar 2021, përmes shpalljes së parë të thirrjes nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për mbështetjen e shërbimeve sociale direkte të ofruara nga strehimoret e licencuara. Ndërmarrjen e masave të menjëhershme për të rregulluar mekanizmin e financimit të qëndrueshëm

edhe për të gjithë shërbimet sociale për fëmijët e cenueshëm, si fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në strehim familjar apo fëmijët e përfshirë në punë të rënda, duke nxjerrë thirrje të rregullta të cilat nuk do të lënë zbrazëti apo boshllëqe kohore të pambuluara financiarisht, gjë e cila ndodh çdo vit dhe rezultojnë me ndërprerje të shërbimeve sociale", thuhet në njoftimin për media.

KOMF ka kërkuar procedimin sa më shpejt të procesit të miratimit të Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal, (i cili aktualisht është në proces hartimi), e i cili parasheh krijimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale, me qëllim zgjidhjen afatgjatë të problemit të financimit të shërbimeve sociale. "Ofruesit e shërbimeve të licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për ofrimin e shërbimeve rezidenciale po vazhdojnë të përballen me paqëndrueshmëri financiare. Shërbimet sociale dhe ato rezidenciale për fëmijët në nevojë, financohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes thirrjeve publike çdo vit dhe çdo vit ka zbrazëti kohore mes thirrjeve/kontratave për mbështetje, duke i lënë pa përkrahje financiare këta



ofruar, çdo fillim viti", thuhet në njoftimin për media.

KOMF-i ka theksuar se edhe këtë vit, strehimoret posedojnë financim vetëm deri më 31 dhjetor 2020, dhe si pasojë e mungesës së financimit strehimoret rrezikojnë të mbyllen përkohësisht nga 1 janari i vitit 2021. "Ndërprerja e ofrimit të këtyre shërbimeve, qoftë edhe përkohësisht do të lërë pa strehë fëmijët e akomoduar aktualisht në këto strehimore dhe po ashtu do të mbyllë derën për rastet e reja që mund të jenë në nevojë për shërbime rezidenciale, duke

shkelur kështu të drejtën themelore të fëmijëve për mbrojtje. Me një situatë të rëndë po përballen edhe ofruesit e shërbimeve për fëmijët e tjerë të cenueshëm. Organizatat ofruese të shërbimeve përmes qendrave ditore dhe shërbimeve në familje e komunitet, nuk kanë marrë asnjë mbështetje financiare përgjatë vitit 2020, nga MPMS. KOMF bën me dije, se në qoftë se nuk do ndërmerren masat e menjëhershme për parandalimin e mbylljes së shërbimeve sociale dhe atyre

rezidenciale për fëmijët viktimat apo ata në nevojë për shërbime apo strehim, të drejtat dhe mirëqenia e fëmijëve në Kosovë do të cenohen rëndë dhe në një mënyrë të paprecedent", thuhet më tej në njoftim.

KOMF-i ka theksuar se ka parasysh që gjendja e përgjithshme ekonomike është rënduar si pasojë e pandemisë Covid-19, por mbrojtja e të drejtave themelore të fëmijëve duhet të jetë prioritet absolut për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke e vendosur këtë prioritet para investimeve kapitale.

## Projektligji për Gjykatën Komerciale drejt finalizimit



PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER)- Pas përfundimit të fazës së konsultimeve paraprake dhe me publikun, si dhe pranimin e komenteve dhe propozimeve, Grupi Punues për hartimin e Projektligjit për Gjykatën Komerciale, ka mbajtur takimin e radhës dhe finalizues me ç' rast janë shqyrtuar të gjitha komentet dhe propozimet e pranuar gjatë fazës së konsultimeve. Grupi Punues i udhëhequr nga zëvendësministri i Drejtësisë, Florian Dushi, me pjesëmarrje të akterëve vendorë dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë

KGJK-në, gjyqtarë të fushës përkatëse, përfaqësues nga Zyra e BE-së, nga Programi i USAID-it për Drejtësi Komerciale, si dhe ekspertë vendor dhe ndërkombëtar, ka shqyrtuar komentet duke u fokusuar në disa prej çështjeve që kanë ngritur interesim të palëve të interesit, siç janë: mjetet e jashtëzakonshme juridike, kompetencat e kryetarit të gjykatës, kriteret për emërimin e gjyqtarëve, kryetarit, si dhe numrin minimal të gjyqtarëve të gjykatës.

Pas shqyrtimit të komenteve dhe

propozimeve, dhe mbi bazën e arsyetimeve, Grupi Punues ka reflektuar për disa prej shqetësimeve të ngritura, siç janë kriteret për kryetarin dhe gjyqtarët e Gjykatës Komerciale, duke mundësuar kështu një garë transparente.

Ministria e Drejtësisë i ka falënderuar të gjitha palët e interesit, me theks të veçantë Zyrën e BE-së, USAID-in, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile, të cilët me komentet dhe propozimet e tyre kanë kontribuar në avancimin e versionit fillestar të projektligjit.

## Spitali i ri i fëmijëve që është donacion i Emirateve Arabe po shkon drejt finalizimit

PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER)- Ushtruesi i detyrës së drejtorit të ShSKUK-së, Saudin Maliqi, dhe ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, kanë qëndruar për vizitë në objektin e ri të Kirurgjisë së Fëmijëve në QKUK, i cili ka hyrë në fazën e fundit të punimeve. Maliqi u shpreh i

lumtur për rrjedhën e punimeve, derisa ndërtimin e objektit të ri e quajti aset të rëndësishëm për shëndetësinë në Kosovë. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, duke falënderuar donatorin për investimin, tha se objekti i ri kirurgjik-pediatrik do të ofrojë

shërbime me cilësore për fëmijët, pa pasur nevojë të kërkojnë shërbim jashtë vendit, kurse për stafin shëndetësor kushte më të mira pune. Objekti i ri i Kirurgjisë së Fëmijëve është një donacion i Emirateve të Bashkuara Arabe, me vlerë prej 22 milionë eurosh



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) ka njoftuar me situatën epidemiologjike në vend

## Mbi 12 000 raste aktive me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) ka njoftuar të enjten se gjatë 24 orëve të fundit 14 pacientë me Covid-19 kanë vdekur dhe se janë regjistruar 807 raste të reja infektimit. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 677 pacientë, kurse numri i rasteve aktive është mbi 12 000

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 19 NËNTOR-** Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë, janë testuar gjithsej 1,816 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 807 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar 14 raste të vdekjes. Rastet e vdekjes janë nga

komunat: Ferizaj tri raste (87, 78, 56 vjeç), Fushë-Kosovë dy raste (69, 51 vjeç), Prishtinë dy raste (77, 73 vjeç), Gjilan një rast (77 vjeç), Kamenicë një rast (87 vjeç), Mitrovicë një rast (73 vjeç), Podujevë një rast (85 vjeç), Rahovec një rast (70 vjeç), Shtime një rast (61 vjeç) dhe Suharekë një rast (71 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 32,022 raste nga 125,792 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 874 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 677 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 19,024 raste, kurse numri i



rasteve aktive është 12,124.

Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 349 raste, Podujevë 56 raste, Ferizaj 55 raste, Prizren 53 raste, Fushë-Kosovë 44 raste, Gjakovë 40 raste, Gjilan 29 raste,

Lipjan 28 raste, Mitrovicë 18 raste, Obiliq 18 raste, Pejë 14 raste, Shtime 12 raste, Kamenicë 11 raste, Suharekë 10 raste, Viti 10 raste, Vushtrri 10 raste, Kaçanik 8 raste, Malishevë 8 raste, Drenas 7

raste, Deçan 5 raste, Rahovec 5 raste, Skenderaj 5 raste, Dragash 2 raste, Graçanicë 2 raste, Istog 2 raste, Klinë 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Klokot, Novobërdë, Shtërpçë dhe Zubin-Potok.



## Kosova pranon ndihma nga Hungaria për t'u përballur me Covid-19

Të enjten ka arritur donacioni i radhës nga ambasadori i Hungarisë, Jozsef Bencze, maska dhe rroba mbrojtëse. "Hungaria gjatë pandemisë ka sjell ndihma të vazhdueshme për Kosovën dhe jemi shumë falënderues. Shtetet mike, janë vlera e Republikës së Kosovës, ndihma në kohë të vështirë, miqësia dhe besimi ndërshtetëror e forcojnë këtë vlerë!", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj.

## Kosova nuk përfaqësohet nga UNMIK-u në Traktatin e Komunitetit të Energjisë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 19 NËNTOR-** Ministrija e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka hedhur poshtë çdo mundësi që Kosova të përfaqësohet nga UNMIK-u në takimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë apo të çdo niveli tjetër. Gjatë takimit me shefin e misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ministrija Haradinaj-Stublla ishte e vendosur për mbrojtjen e integritetit dhe kushtetutshmërisë së Republikës Kosovës, në secilin mekanizëm ndërkombëtar, duke bërë të qartë se koha kur Kosova përfaqësohej nga UNMIK-u ka përfunduar më 17 shkurt 2008 me Shpalljen e Pavarësisë, dhe është vulltosur nga Gjykata Ndërkombëtare e

Drejtësisë në korrik të vitit 2010. "Është fakt i njohur ndërkombëtarisht tashmë se në Republikën e Kosovës ekziston një realitet i ri politik e ligjor, i bazuar në Deklaratën e Pavarësisë, Kushtetutën, vendimin e GjND-së dhe ligjet e tjera të aplikueshme. Kjo nënkupton që Republika e Kosovës, në asnjë rast NUK mund të përfaqësohet në çfarëdo nisme ndërkombëtare, nën emërtimin e UNMIK-ut, aq më tepër kur ky mision për ne ka përfunduar me 17 shkurt 2008" është shprehur ministrija Haradinaj-Stublla gjatë takimit. Komisioni Evropian synon që të miratojë, më datën 27 nëntor një amendament në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, të nënshkruar në vitin 2005 ku palë themeluese ishte edhe Republika e Kosovës por që asokohe



përfaqësohej nga UNMIK-u. Kërkesa që Kosova të përfaqësohet nga UNMIK-u mbledhjen e radhës të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, është refuzuar nga ministrija Haradinaj-Stublla, e cila ka udhëzuar të gjitha institucionet e vendit që të mos pranojnë përfaqësimin nën emërtimin UNMIK, me asnjë kusht dhe në asnjë rrethanë, sepse kjo është tendencë e Serbisë, dhe përveç që është jokushtetuese për ne, është rrjedhimisht e jashtëligjshme ndërkombëtarisht, duke rikthyer vëmendjen në vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND), i cila ka shpallur Deklaratën e Pavarësisë të Republikës së Kosovës, 17 shkurt 2008, në tërësi në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare.

# ATK-ja dhe AKK-ja pajtohet për arritjen e një memorandumit të përbashkët



PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER)-Ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të ATK-së, Ekrem Hysenaj, ka pritur në takim kryeshefin ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, me të cilin ka diskutuar për tema që ndërlidhen me aktivitetet e këtyre dy institucioneve. Sipas një njoftimi të ATK-së, qëllimi i këtij takimi ishte

ofrimi dhe shkëmbimi elektronik i të dhënave të sistemit kadastral për Administratën Tatimore të Kosovës, të cilat do të mundësonin qasje aktive, si dhe në të njëjtën kohë do të eliminonin procedurat burokratike ose shkëmbimin fizik të të dhënave.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të ATK-së,

Ekrem Hysenaj, gjatë takimit ka ngritur tri çështje të cilat duhet të unifikohen bashkërisht me AKK-në, atë për pjesën e të dhënave të pasurisë së paluajtshme të tatimpaguesve, unifikimi i adresarit të tatimpagueseve, si dhe heqja e tarifës administrative për ATK-në në rastet e vendosjes së barrës tatimore për tatimpaguesit nëpër zyrat e

kadastrave.

Ndërkaq kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, ka thënë se janë të interesuar që të ngritin në tjetër nivel bashkëpunimin e dy institucioneve, pasi që janë shumë pika të cilat ATK-ja dhe AKK-ja duhet patjetër të kenë të intensifikuara kanalet e komunikimit. "AKK-ja tani ka një

platformë moderne digjitale, e cila do të mundësojë alternativë të ndryshme në vijën komunikuese dhe bashkëpunuese", ka thënë ai. Në fund të këtij takimi, të dy palët u pajtuan që gjatë ditëve në vijim të nënshkruhet një memorandum bashkëpunimi, i cili do të jetë hap i rëndësishëm në konkretizimin e pikave, të cilat u ngritën gjatë këtij takimi.

# PD-ja, e shqetësuar për mosmiratimin e pakos së rimëkëmbjes ekonomike



PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER)-Partia e Drejtësisë (PD) është shprehur e shqetësuar me taktikat e subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës në kohë pandemie. Sipas PD-së, ato duke mos e votuar Projektligjin e rimëkëmbjes ekonomike edhe pas shumë përpjekjeve të vazhdueshme nga ana e qeverisë, vetëm se po e rëndojnë gjendjen edhe ashtu të rënduar ekonomike. "Partia e Drejtësisë drejton kritika edhe ndaj qeverisë që nuk po mundë të mbledhë numrin e deputetëve shumicë dhe ta votojë si pako e propozuar dhe

e votuar në leximin e parë. Shqetësim shpreh edhe ndaj moskomunikimit dhe moskoordinimit të qeverisë me subjektet tjera të opozitës", është thënë në reagimin e PD-së.

Ky subjekt politik ka theksuar se qeveria Hoti nuk po jep sinjale të qarta se është për bashkëpunim me opozitën. "Ajo nuk po tenton t'i mbushë mendjen asnjëherë nga subjektet e përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës për pakon e rimëkëmbjes, e cila mundë të jetë një shpresë e vogël për qytetarët. Siç duket as qeveria tani më nuk është e sigurt ndaj kësaj pakoje. Si pako e

përgatitur kohë më parë nuk arriti në shërbim të qytetarëve me kohë, dhe tani pandemia me përmasat që ka marrë kërkon ndërhyrjen e dytë apo edhe të tretë si pako rimëkëmbje ekonomike", është theksuar në këtë reagim.

PD-ja ka vlerësuar se qytetarëve në përgjithësi dhe bizneset që vazhdimisht po tkurren për nga numri, u ka humbur durimi dhe shpresa, pasi që dora e shtetit e cila vjelë vazhdimisht nga qytetarët nuk e përtheten atë në obligimet ndaj tyre, sidomos në situatat të jashtëzakonshme siç është edhe kjo e pandemisë Covid-

19. "Qeveria qëndron duke bërë sehir, duke përdorur një sistem të qeverisjes periferike, duke mos qarë hallin për mirëqenien e jetës së qytetarëve, dhe asnjëherë nuk tentoi t'i bindë qytetarët se po punon në të mirë të tyre", thuhet në reagim.

PD-ja ka theksuar se si faktorë tjetër që po nxitë të përkeqësohet gjendja ekonomike dhe sociale në tërë Kosovën, dhe në të njëjtën kohë të rritet kërkesa për konsum në gjërat elementare të një familje dhe të atyre për barëra, është edhe rritja e numrit të përditshëm të të infektuarve si

dhe humbja e shumë vendeve të punës. "Partia e Drejtësisë kërkon edhe nga subjektet tjera të përfaqësuara në Kuvend, që të reflektojnë sa më shpejt drejt miratimit të ligjit për rimëkëmbje ekonomike, dhe qytetarët të fillojnë të marrin ndihmën e propozuar edhe ashtu të vonuar. Me shpresën se do të kalojmë edhe këtë sfidë si shumë të tjera, qytetarët do të jenë të vëmendshëm karshi përfaqësuesve të tyre në të ardhmen, duke kërkuar më shumë përgjegjësi dhe angazhim në të mirë të zgjedhësve të tyre", është thënë ndër të tjera në reagimin e PD-së.



## Ministri Reçica në përkrahje të punëkërkesve për hapjen e bizneseve të reja

PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER)- Me qëllim të mbështetjes së vazhdueshme për punëkërkesit në Kosovë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë, ka shpallur të hapur fazën e dytë të Programit të Vetëpunësimit 2020, për punëkërkesit e riatdhesuar në Kosovë.

Lidhur me këtë, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se, me anë të programit do të mbështeten punëkërkesit e riatdhesuar, në hapjen e bizneseve të tyre të profileve të ndryshme, biznese që janë në gjendje t'i mbijetojnë tregut konkurrues të punës.

Po ashtu, ai ka thënë se, kjo përkrahje e shtuar vjen në këtë kohë të përbaljes me

pandeminë Covid-19, në mënyrë që punëkërkesit në Kosovë të ndjejnë edhe më shumë dorën kujdesit nga shteti.

Gjithashtu, ministri Reçica ka theksuar se në fazën e parë të programit të vetëpunësimit këtë vit, janë mbështetur 136 punëkërkes të riatdhesuar të cilët tashmë kanë hapur bizneset e tyre dhe kanë nisur punën.



## Ekzekutohet ndihma financiare prej 1 milion eurosh për "Trepçën"



PRISHTINË, 19 NËNTOR (ER)- Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka ekzekutuar ndihmën financiare për "Trepçën", në vlerë prej 1 milion eurosh. Kjo ndihmë u ekzekutua të enjten për shkak të

teknikaliteteve të bartjes së mjeteve në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit. "Duhet të sqarohet që pjesa prej 100,000.00 eurosh, që e kompletion ndihmën prej 1.1 milionë euro, do të ndahet gjatë

javës tjetër për shkak se këto alokime nga buxheti i pakos së rimëkëmbjes ekonomike do të duhet të votohet në Qeveri mbi kriteret dhe motivet e ndihmës për subjektet e caktuara. Pra nuk është vetëm ndihma prej 1 milionë

euro, por do t'i bashkohet edhe shuma prej 100,000.00 eurosh. Ne jemi të përkushtuar që të zgjidhim problemet e ndërmarrjeve publike, sidomos në kohën e pandemisë Covid-19, pasi kemi ndjeshmërinë e secilës familje të

punëtorëve të 'Trepçës'. Duhet të kuptojnë edhe punëtorët që ka procedura për transferim të mjeteve dhe nuk është çështje minutash", është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

## Jep dorëheqje ushtruesi i detyrës së kryeshefit të "Trepçës", emërohet i riu

Prishtinë, 19 nëntor (ER)- Ushtrues detyrës së kryeshefit të ndërmarrjes "Trepça" do të jetë Enes Muzaqi. Emërimi i tij në këtë pozitë vjen pas dorëheqjes se Hysen Vrajollit si ushtrues i detyrës së kryeshefit të "Trepçës". Vrajolli ka deklaruar se ka dhënë

dorëheqje pas presioneve të vazhdueshme nga kryeministri dhe ministri i Zhvillimit dhe Ambientit. "Në javën e fundit vetëm janë intensifikuar presionet për dorëheqje pa arsytim dhe Bordi e ka ditur që s'ka arsye për të më shkarkuar. Prandaj, të enjten kamë dhënë vet

dorëheqje", ka thënë Vrajolli. Minatorët e kombinatit metalurgjik "Trepça" kanë përfunduar të enjten grevën, pasi që iu është konfirmuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit se pagat për muajin tetor do të transferohen në llogaritë e tyre.



# Ferizaj shënon Ditën Botërore për parandalimin e abuzimit me fëmijët

**FERIZAJ, 19 NËNTOR (ER)**- Rrethanat pandemike kanë penguar zhvillimin normal të një mori aktiviteteve të planifikuara kohë më parë nga grupe e organizata të ndryshme. Kështu, edhe aktivitetet e planifikuara të mbahen përkthazi me Ditën Botërore për Parandalimin e Abuzimit të Fëmijëve, të organizuara nga Qendra për Arsim të Kosovës (KEC) në partneritet me Qendrën për Studime të Avancuara (FIT) shënuan në Ferizaj, Ditën Botërore të Parandalimit të Abuzimit të Fëmijëve. Me mesazhe, thënie, piktura e vizatime të ndryshme, shkollarët dhanë mesazhin e tyre për këtë ditë, duke thirrur në ndërgjegjen shoqërore për ndalimin e abuzimit me fëmijët. Kjo ngjarje u shënuar në

kuadër të projektit “Së bashku kundër abuzimit të fëmijës - TACA”, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të Instrumentit për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR).

Projekti “Së bashku kundër abuzimit të fëmijës” është mbikëqyrtur nga koordinatori i projektit, Ardita Kabashi në bashkëpunim me koordinatorin e terrenit për Ferizaj, Arben Aliu me përkrahjen edhe të Komunes së Ferizajt.

Aktiviteti për të shënuar 19 Nëntorin - Ditën Botërore Kundër Abuzimit të Fëmijëve ka përfshirë të gjitha shkollat e Komunes së Ferizajt, ku fëmijët kanë shfaqur idetë e tyre përmes vizatimeve dhe shkrimeve letrare.



## Komuna e Skenderajt do të ndihmojë 1000 familje në nevojë

**SKENDERAJ, 19 NËNTOR (ER)**- Është mbajtur mbledhjen e radhës e Shtabit Emergjent të Komunes së Skenderajt për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Me qëllim të menaxhimit efikas të kësaj situatë si dhe përkrahjes së familjeve në nevojë, të cilave u është renduar gjendja ekonomike pas paraqitjes së pandemisë, kryetari i komunës, Bekim Jashari, gjatë kësaj mbledhje në koordinim me anëtarët e shtabit, mori vendim



që të ndihmohen 1000 familje në nevojë me pako ushqimore dhe me miell.

Në anën tjetër drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Ibush Hetemi si dhe drejtuesi i QKMF-së, Osman Veliu, njoftuan lidhur me gjendjen e komunës përball betejës me korona virus, duke e konsideruar si gjendje aktualisht të menaxhueshme. Gjithashtu edhe Komandanti i Stacionit Policor në Skenderaj,

Bastri Durmishi si dhe Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Bekim Latifi, bënë të ditur se edhe situata në siguri dhe në arsim po menaxhohet si duhet nga institucionet përkatëse. Gjatë këtij takimi kryetari Jashari bëri thirrje për qytetarët që të vazhdojnë t'i përmbahen vendimeve të Qeverisë së Kosovës si dhe rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Institutit për parandalimin e infeksionit Covid-19.

## Komuna e Mitrovicës dhe policia ofrojnë siguri për banorët e Kçiqit të Madh pas rasteve të vjedhjeve

**MITROVICË, 19 NËNTOR (ER)**- Kryetari i Komunes së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me kryesuesin e Kuvendit Komunal, Safet Kamberi, si dhe komandantin e Policisë së Stacionit Jugor në Mitrovicë, Ahmet Xhoshja, me zyrtarë policorë, janë mirëpritur në takim të paraparë me kryesinë e fshatit Kçiq i Madh, ku morën pjesë edhe disa banorë nga ky fshat. Qëllimi i këtij takimi ishte të njoftohen banorët lidhur me menaxhimin e situatës së sigurisë në fshatin Kçiq të Madh, paraqitja e shqetësimeve dhe kërkesat e banorëve, si dhe ofrimi i mbështetjes nga institucionet përgjegjëse, lidhur me rastet e fundit të vjedhjeve në shtëpitë e banorëve të këtij fshati.

Fillimisht kryetari Bahtiri, ka thënë se ndihet i nderuar që



ndodhet në mesin e banorëve të Kçiqit, dhe se bashkë ndjenë me situatën në të cilën ndodhen, dhe shqetësimet që

kanë ata me rastet e vjedhjeve të ditëve të fundit në këtë fshat. Më tutje kryetari Bahtiri, ka thënë se qëllimi kryesor i

vizitës së tij në fshatin Kçiq është ofrimi i mbështetjes maksimale nga ana e komunës dhe e Policisë së Kosovës, për

t'ju ndihmuar në aspektin e sigurisë dhe përkrahjen e kërkesave apo shqetësimeve të tyre.

# MES MOSPËRFILLJES, KUSHTËZIMIT DHE INJORANCËS (3)



**Shkruan: Agron HOTI**

Qysh prej anëtarësimit në CEFTA e deri më sot, Kosova është përballur me bllokada të panumërta nga mosnjohëset e pavarësisë së Kosovës si Serbia, Bosnja e Hercegovina dhe Moldavia sa u përket eksporteve. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kur kompanitë e Kosovës filluan të përdornin vulat e shtetit të Kosovës, u ndaluan të eksportojnë në Serbi, Bosnje e Hercegovinë dhe Moldavi. Kjo bllokadë, bëri që mallrat e Kosovës të eksportoheshin në Serbi, Bosnje e Hercegovinë dhe Moldavi përmes ndonjë shteti tjetër dhe duke gjetur tregje tjera. Kjo formë e eksporteve përbënte kosto shtesë për bizneset vendore ashtu sikundër që dekurajonte investitorët e huaj. Ndërkohë që kjo bllokadë që po i bëhej Kosovës nuk po merrej me shqetësimin e nevojshëm nga BE, diçka që vazhdon edhe sot. Përfundimisht pasojat e futjes së Kosovës në CEFTA ishin fatale për ekonominë e Kosovës. Kjo sepse në vend që të ulej deficitin tregtar, ai përkundrazi u rrit mbi 2 miliard EUR. Kjo tregonte më së miri se kur një ekonomi e shkatërruar nga lufta futet në Zonë të Tregtisë së Lirë, atëherë lëngimi i saj do të bëhet afatgjatë dhe me pasojat për fuqinë e re

punëtore të Kosovës. Institucionet e Kosovës, pas vitit 2008, për hir të stabilitetit dhe bashkëpunimit me bashkësinë ndërkombëtare nuk ishin asnjëherë në gjendje të mbronin ekonominë vendore duke subvencionuar e promovuar eksportet dhe duke vendosur tarifa dhe kuota për produkte të caktuara ndaj importeve, në mënyrë që ekonomia jonë të merrte veten. Ndërkohë që vendet e rajonit ndërmerrnin çdo veprim që dekurajonte zhvillimin ekonomik në Kosovë. Prej vitit 2007 kur Kosova kishte hyrë në CEFTA e deshën të kalojnë 11 vite për t'u vënë taksë importeve nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, të cilat para syve të BE-së po pengonin dhe dekurajonin eksportin e Kosovës. Edhe kur kjo taksë u ngrit nga Kosova, pati një vërsulje të paparë të BE-së jo për të disiplinuar Serbinë dhe Bosnje e Hercegovinën për pengesat e hapura që po i bënin Kosovës, por për të bërë presion që Kosova ta heqë taksën siç në fakt edhe ndodhi. Dalja nga CEFTA asnjëherë nuk është shtruar si mundësi duke marrë parasysh se prioritet numër një ishte bërja dhe konsolidimi i shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, diçka që ishte e pamundshme pa ndihmën e miqve tanë ndërkombëtarë. Në këtë kuadër, dalja e Kosovës nga CEFTA do të përbënte shembullin më të keq të mundshëm të Kosovës karshi frymës së BE-së për thellimin e bashkëpunimit rajonal mes vendeve të Ballkanit Perëndimor si dhe frymës globale neoliberale për hapje të

ekonomive e jo mbylljeve. Dikush sot flet lirshëm, por, të gjithë e dinë se me sa llupë në atë kohë mbikëqyrej dhe kërkohesh bashkëpunimi i Kosovës me rajonin dhe bashkësinë ndërkombëtare.

Edhe fryma globale gjatë kësaj periudhe (2001-2008) ishte rritja e shkëmbimeve tregtare anembanë globit, frymë kjo që mbështetej edhe nga Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) dhe mekanizma tjerë ndërkombëtarë, përfshirë shtetet e fuqishme në glob dhe korporatat multinacionale, pra ato shtete që pritej të mbështesnin pavarësinë e Kosovës ashtu siç në fakt edhe ndodhi. Pra, përballë kushtëzimeve para bashkësisë ndërkombëtare, më saktësisht ndaj perëndimit, e cila ishte qenësore në shtet-bërjen e Kosovës dhe frymës globale për hapje të ekonomive, institucionet e Kosovës nuk kishin shumë mundësi për të zgjedhur.

Por, edhe sikur të kishin mundësi për të zgjedhur brenda atyre rrethanave, forcave politike në Kosovë për shkak të promovimit të injorancës në masë të madhe dekurajonin zhvillimin ekonomik dhe profesionalizmit. E vërteta e dhimbshme është se ekonomia e Kosovës edhe pse me rritje mesatare të qëndrueshme prej 4% nuk po mund të ecte me hapat që do të duhej të kishte ecur sikur të ishte mbrojtur ekonomia vendore nga vërshimi i produkteve rajonale dhe dekurajimi ekonomik i Kosovës nga CEFTA, UNMIK-u

dhe injoranca e forcave politike në Kosovë.

Dhe në një kohë kur deficitin tregtar i Kosovës po shënonte rritje të paparë që nga viti 2001 deri në vitin 2015, institucionet e Kosovës - në kohën kur ekonomia globale kishte filluar të tkurrej për shkak i krizës financiare globale që solli recesionin më të madh ekonomik në botë që pas Depresionit të Madh të vitit 1933, nga i cili as sot nuk po mund të del ekonomia botërore - me dëshirën për avancim në rrugëtimin evropian nënshkruan Marrëveshjen Stabilizim Asociim (MSA), e cila hyri në fuqi me 1 prill 2016. Nëse shikohen statistikat e vitit 2016 shihet se deficitin tregtar i vitit 2016 ishte rritur për 7.4 për qind krahasuar me vitin 2015, pra Kosova në vitin 2016 kishte eksportuar 309.6 milionë euro, ndërsa kishte importuar 2.789.4 miliardë euro, për më tepër eksporti i mallrave i vitit 2016 krahasuar me vitin 2015 kishte shënuar rënie me një balancë negative prej -4.8, gjë që pritej në vitet e para pas hyrjes në fuqi të MSA-së.

Edhe pas hyrjes në fuqi të MSA-së statistikat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregojnë që tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë flet për një deficit tregtar më të lartë për (13.4 për qind) në muajin mars 2019, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2018, gjegjësisht në vlerë prej 259.6 milionë euro krahasuar me deficitin 228.9 milionë euro në vitin 2018. Pra, të dhënat bindin se - edhe pse Kosova që nga paslufta ka pasur një rritje ekonomike mesatare të qëndrueshme prej 4 për qind, e

cila sipas librit të Rushir Scharma "Ngritja dhe rënia e kombeve" është rritja më e qëndrueshme ekonomike së paku prej pas luftës së dytë botërore deri më sot - gjendja ekonomike e Kosovës që mbretëronte menjëherë pas luftës në Kosovë, kërkonte rritje më të madhe ekonomike për të qenë më konkurruese me rajonin dhe më gjërë.

Suma sumarum, nuk duhet harruar asnjëherë se Kosova ishte dhe është shumë e vogël për t'i dalë përballë frymës neoliberale, pra hapjes së ekonomisë, de-rregullimit, rritjes së shkëmbimeve tregtare, e cila përmes rritjes së Zonave të Tregtisë së Lirë në glob po promovohet e inkurajohej nga Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) dhe vendet eksportuese. Kjo frymë vazhdon edhe sot dhe me shumë gjasë edhe nesër.

Po të ishte hapur ngadalë, kujdesshëm dhe mençur ekonomia e Kosovës, sigurisht që gjendja ekonomike sot do të ishte shumë më e mirë se sa që është, por meqë kjo nuk ka ndodhur, sepse në njërin anë ishim të kushtëzuar me shtetbërje e shtetkonsolidim, gjersa në anën tjetër po na ndodhte dekurajimi i zhvillimit ekonomik jo vetëm nga UNMK-u po edhe nga forcat politike në Kosovë, atëherë do të na duhet shumë kohë për të kapur trendet. Në qoftëse ShBA u mbetet besnike projeksioneve për Kosovën dhe Shqipërisë të bëra të ditura më 4 shtator 2020, atëherë, Kosova në 10 apo 15 vitet e do të jetë qendër punësimi dhe zhvillimi ekonomik në rajon. (FUND)


## Kryetari Gashi kërkon më shumë mbështetje nga qeveria për komunat

**OBILIQ, 19 NËNTOR (ER)**- Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka zhvilluar një takim me zëvendëskryeministrin Besnik Tahiri, të cilin e ka njoftuar për situatën aktuale me pandeminë Covid-19 në Komunën e Obiliqit, me sfidat me të cilat po ballafaqohen në këtë kohë, po ashtu, ai ka kërkuar nga Tahiri, që Qeveria e Republikës së Kosovës të ofrojë më shumë mbështetje për institucionet e nivelit lokal duke pasur

parasysh se komunat janë institucioni i parë dhe më i afërt për qytetarët në këtë betejë me virusin Covid-19.

Nga ana tjetër, zëvendëskryeministri Tahiri është zotuar se institucionet qendrore do të përkrahin komunat në vazhdimësi, sepse sfida me këtë pandemi është e përbashkët dhe përmes koordinimit ndër-institucional do të ofrohen mundësi më të mira për qytetarët.





QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## 'Dardanët' në karantinë

"Ne jemi grumbulluar dhe do të qëndrojmë së bashku deri para udhëtimit në Sllovakë. Kjo është bërë për shkak të situatës me pandeminë e Covid-19. Do të mbajmë stërvitje dhe do ta shfrytëzojmë këtë kohë maksimalisht për tu përgatitur. Edhe në Sllovakë gjithashtu do të kemi stërvitje para ndeshjeve zyrtare. Do të mundohemi të japim maksimumin në këto ndeshje", ka thënë Rugova

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Basketbollistët e Kosovës të mërkurën mbrëma janë vendosur në karantinë para ndeshjeve në kuadër të Dritares së Dytë të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. Të mërkurën mbrëma kanë pasur stërvitjen e parë dhe kështu do të vazhdojnë deri të hënën kur do të nisen për në Bratisllavë. Ata do të qëndrojnë të karantinuar pa pasur kontakte me askënd, për shkak të situatës

me pandeminë. Kosova më 26 nëntor do të përballet me Sllovakinë, kurse dy ditë më pas me Islandën. Dy takimet do të zhvillohen në Bratisllavë. Drejtori i Përfaqësuesëve të Kosovës, Granit Rugova, ka folur për përgatitjet. "Ne jemi grumbulluar dhe do të qëndrojmë së bashku deri para udhëtimit në Sllovakë. Kjo është bërë për shkak të situatës me pandeminë e Covid-19. Do të mbajmë stërvitje dhe do ta shfrytëzojmë këtë kohë

maksimalisht për tu përgatitur. Edhe në Sllovakë gjithashtu do të kemi stërvitje para ndeshjeve zyrtare. Do të mundohemi të japim maksimumin në këto ndeshje", ka thënë Rugova përfaqësues nga dy ndeshje, ka shënuar dy fitore, duke mundur Islandën dhe Luksemburgun për të qenë lidere e grupit, kurse në muajin shkurt të vitit të ardhshëm do të përballet me Sllovakinë dhe Luksemburgun.



## Distria Krasniqi e fitoi medaljen e bronzit në Evropian



PRAGË, 19 NËNTOR - Xhudistja Distria Krasniqi e ka fituar medaljen e bronzit në Kampionatin Evropian 2020 në kategorinë deri në 48 kilogramë, pasi e mposhti në Pragë të Republikës së Çekisë, xhudisten franceze Melanie Clement. Kjo është medalja e dytë për Krasniqin në Kampionat Evropian, pas të argjendtës që e kishte fituar në vitin 2018 në Tel Aviv të

Izraelit. 24-vjeçarja u befasua nga Shirine Boukli, e cila e mundi në çerekfinale. Rundin e parë Krasniqi e kaloi pa luftë, ndërsa çerekfinalen e arriti pas fitores kundër Aisha Gurbanlin në luftën e parë të saj në këtë Evropian. Pas humbjes në çerekfinale, ajo u plasua direkt në gjysmëfinale për medaljen e bronzit, ku e mundi rusen Irina Dolgova për një vend në finale. Ndaj Clement, Krasniqi

fitoi pa shumë telashe dhe pas pak më shumë se një minute, kur e hodhi në dysheme dhe fitoi me dorëzim. Ndërkohë, Flaka Loxha në luftën e dytë u mposht nga Julia Kopalczyk me një waza-ari. Loxha në raundin e parë në kategorinë deri 57 kilogramë e kishte mposhtur ukrainasen Mariia Skora. Të premtën garon Lorian Kukan ë kategori deri 78 kilogramë.

## Mezani: Gjilani synon pjesëmarrjen në Kupat e Evropës

GJILAN, 19 NËNTOR - Gentian Mezani është rikthyer në stolin e Gjilanit pas pesë javëve mungesë. Tekniku shqiptar në kohën sa mungoi u zëvendësua me mjaftë sukses nga Sallah Sherifi i cili arriti rezultate fasionuese. Tashmë Gjilani gjendet shumë afër dy skuadrave lidere, Dritës dhe Ballkanit. Trajneri i "Skifterave"

është prononcuar për mediumin shqiptar "PanoramaSport", ku ka treguar për objektivat e skuadrës dhe ecurinë e kampionatit. "Të them të drejtën, shpresoja të shkonim akoma më mirë, por dëmtimet e shumta në repartin e sulmit na kanë krijuar shumë probleme. Gjithsesi, e përgjithshmeja është pozitive

dhe shpresojmë që të përmirësohemi nga ndeshja në ndeshje", ka thënë Mezani. "Objektivat pa diskutim që janë Kupat e Evropës, por sipas gjendjes së renditjes ne do të kërkojmë edhe diçka më shumë", ka shtuar trajneri. Gjilani luan në vikend një ndeshje interesante që e përballë kundër Drenicës.



## Hadergjonaj: Vit i tmerrshëm për Kosovën, ta harrojmë sa më shpejtë

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Mbrojtësi i Përfaqësuesës së Kosovës, Florent Hadergjonaj ka shfrytëzuar rrjetet sociale për të folur rreth edicionit të dështuar të "dardanëve" në Ligën e Kombeve. Kosova e

mposhti në ndeshjen e fundit Moldavinë, duke e regjistruar fitoren e vetme në gjashtë ndeshjet e zhvilluara. Se edicioni i Ligës së Kombeve dhe ky vit ishte i dështuar për Kosovën e mendon

edhe mbrojtësi Hadergjonaj. "Ishte një vit i tmerrshëm që duam ta harrojmë sa më shpejtë", ka shkruar Hadergjonaj në profilin e vet në "Facebook". "Mirë që fituam, pasi na shërben për ta

ngritur moralin dhe entuziazmin. Tani shpresojmë të vazhdojmë me fitore. Faleminderit të gjithëve për mbështetjen e madhe që na keni dhënë", ka shtuar Hadergjonaj.



## Guardiola rinovon kontratën me Cityn

MANCHESTER, 19 NËNTOR - Tashmë është zyrtare: Pep Guardiola ka rinovuar edhe për dy vite të tjera kontratën me Manchester Cityn. Strategu katalanas ka zgjidhur aventurën

e tij në Manchester deri në vitin 2023, e cila është në fakt më gjata në karrierë. Ai kaloi fillimisht pak më shumë se 4 vite te Barcelona, 3 në Gjermani me Bayernin dhe është që nga

viti 2016 me Cityn, ku ka fituar 8 trofe. "Që kur kam mbërritur te Manchester City jam ndjerë i mirëseardhur, në klub dhe në qytet. Deri tani kemi kaluar shumë gjëra së bashku,

shënuar gola, fituar trofe, jemi krenar për sukseset që kemi arritur. Kam të gjitha mundësitë për të bërë mirë punën dhe jam i nderuar për besimin", ka thënë Guardiola.



## Favre: Do të vazhdojë mbështetja e UEFA-s për projektet e FFK-së

PRISHTINË, 19 NËNTOR - Zëvendës-presidenti i Asociacioneve në UEFA dhe njëherësh kryesuesi i programit "HatTrick", Thierry Favre të enjten ka vizituar selinë e FFK-së, ku është pritur nga kryetari Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu. Me këtë rast është diskutuar edhe për projektet e FFK-së të përfituara nga programi "HatTrick" siç është zhvillimi i talenteve të reja "Elite Youth Development Programme U15", programi "Grassroots", pastaj edukimi i trajnerëve si dhe programet e ndryshme për fëmijët, komunitetet dhe personat me nevoja të veçanta. Rreth këtyre projekteve, Favre u njoftua nga përgjegjësit Michael Ness, Edmond Rugova dhe Sanije Krasniqi. Më pas zyrtari i lartë i UEFA-s vizitoi zyrat e reja të FFK-së, si dhe Kampin Edukativ në Hajvali. Favre u shpreh tejet i kënaqur me punën e bërë nga FFK-ja dhe me realizimin e të gjitha projekteve të parapara, derisa shprehu mirënjohjen ndaj kryetarit Ademi dhe sekretarit të përgjithshëm Salihu për menaxhimin e mirë të punëve në kohë pandemie. Ai po ashtu theksoi se mbështetja e UEFA-s për



projektet e FFK-së do të vazhdojë edhe në të ardhmen. "Jam i kënaqur me punën në FFK. Me ndërkombëtarizimin e futbollit çdo gjë filloi shumë mirë dhe shumë shpejt. Jam i lumtur që jeni duke i bërë zyrat e reja. Me sa e di një ndër projektet e para strategjike të identifikuar ka qenë Qendra e re Stërvitjeve të Kombëtareve, në të cilën mendoj se duhet të bëjmë përpjekjet maksimale. Pjesa më e madhe e projektit të UEFA-s është implementuar dhe ne jemi të kënaqur dhe mezi presim të

kthehemi prapë këtu. Gjithashtu e kuptoj edhe zhgënjimin me ndeshjen e 'play-off'-it në Shkup. Mendoj që me fillimin e marsit të ardhshëm (kualifikimet e Botërorit, v.j) stabiliteti i futbollit do të kthehet dhe gjithashtu duhet të mbani entuziazmin tuaj që keni për ekipin kombëtar. Sa i përket FFK-së nuk shohim ndonjë rrezik që ndonjë nga projektet e UEFA-s të mos mund të financohet. Kjo është edhe njëra prej përgjegjësisve të mia kryesore në kuadër të UEFA-s", ka deklaruar Favre.

## Marku: Askush nuk e ka shpejtësinë time

LONDËR, 19 NËNTOR - Florian Marku fitoi për vetëm 101 sekonda ndaj Muma Mweemba dhe pas asaj sfide ai i hapi sfidë të gjithë boksierëve të peshës së tij në Britani. Së fundmi ai ka dhënë një intervistë të gjatë për "Mirror" dhe mes të tjerash ai shprehet se askush në peshën e tij nuk ka aftësitë e tij. Lushnjari tenton të hyjë në listën e më të mirëve të Anglisë dhe së fundmi duket se i është përkushtuar më shumë boksit. "Krahasuar me një vit më parë, tani jam një luftëtar krejtësisht tjetër. Në ndeshjen e fundit timen, nuk keni parë asgjë. Patë vetëm pak nga lëvizjet e mia. Asnjë boksier i peshës së lehtë nuk ka shpejtësinë dhe fuqinë time. Mund ta dalloni lehtë këtë. Shumë njerëz mendojnë se unë i shpejtoj



videot e mia, por nuk është e vërtetë. Ajo është shpejtësia ime reale. Unë jam paketë e plotë, më kuptoni besoj", ka thënë Marku.

### SHKURT

#### Terimi e do Shaqirin te Galatasaray

Trajneri i Galatasarayt, Fatih Terim refuzon të heqë dorë nga shpresat për ta transferuar yllin shqiptar të Liverpoolit, Xherdan Shaqirin. Anëtori shqiptar nuk po luan mjaftueshëm te Liverpooli dhe një largim i tij përfolët që disa afate kalimtare. Klubi i madh turk, Galatasaray është njëri nga klubet që është lidhur më shumë me transferimin e shqiptarit. Trajneri Terim është një tifoz i madh i futbollit nga Gjilani dhe ka shtyrë drejtuesit e Galatasarayt për të sjellë sulmuesin në Stamboll. Sipas mediumit turk "Fotomac", Galatasaray dhe Terim do të provojnë përsëri për Shaqirin në afatin e janarit.

#### Ramosi edhe dy vjet nuk largohet nga Real

Kapiteni i Real Madridit, Sergio Ramos ka një marrëveshje për të vazhduar me skuadrën "mbretërore" edhe për dy vite të tjera, raporton "El Larguero". Kontrata aktuale e Ramos skadon në fund të këtij edicioni, ku për shumë ditë është spekuluar mbi të ardhmen e tij, duke u lidhur me shumë skuadra evropiane. Raportohet se interesimin më të madh për Ramos e kanë shprehur Juventusit dhe Paris Saint-Germain, por si duket spanjollit do të jetë pjesë e "Galaktikëve" të paktën edhe për dy vite tjera.

#### Messi: Jam lodhur duke qenë problemi për gjithçka te Barcelona

Deklaratat e fundit të Lionel Messit kanë vënë edhe një herë në qendër të vëmendjes marrëdhëniet e tij të krisura me Barcelonën, pikërisht kur u duke se ato ishin marrë fund. Gjashtë herë fituesi i "Topit të Artë" është kthyer në Barcelonë pas paraqitjeve të mira me Argjentinën, ku mundën Perunë 2-0 në kualifikimet për Kupën e Botës. "E vërteta është se unë jam lodhur duke qenë problemi për gjithçka te Barcelona", ka thënë Messi.

#### Immobile shërohet nga Covid-19

Ciro Immobile më në fund rezultoi negativ në tamponin e fundit. Për trajnerin e Lazios, Simone Inzaghin, kthimi i sulmuesit është një lehtësim i madh në një moment vështirësi në nivelin fizik. Ai duhet të kthehet në fushë ndaj Crotones dhe gjithashtu mund të jetë në dispozicion për ndeshjen e Ligës së Kampionëve kundër Zenitit. Immobile mbërriti në Paideia rreth orës 08:00 dhe bëri shaka me të pranishmit, që e pyetën nëse mund të kontribuonte në ndeshjen kundër Crotones: "Sigurisht, përndryshe nuk do të isha qenë këtu ...".

## Casillasi dëshiron të kthehet në Real

Iker Casillas e ka pranuar se do ta dëshironte rikthimin në Real Madrid, klubin ku i kaloi ditët më të mira të karrierës profesionale si portier. Legjenda spanjolle ka

promovuar dokumentarin e tij "Krahët e varur", pasi që u pensionua nga futbollit. Pas problemeve me zemër, Casillas publikoi dokumentarin, në të cilin u

është përgjigjur pyetjeve për një rikthim në "Santiago Bernabeu", ku i kishte kaluar për 25 vjet të karrierës. "Është ëndërr e imja sepse mund të ndihmojë klubin më të famshëm në

botë, sepse unë e njoh atë shumë mirë", ka thënë Casillas. "Nuk e di se çfarë do të ndodhë, por do të ishte me të vërtetë e veçantë të kthehesha dhe të isha në gjendje të

transmetoja ato vlera që ata më mësuhan si fëmijë. Unë kurrë nuk do të mbyll një derë ku nesër mund të jem i lumtur dhe i kënaqur përsëri", ka shtuar ish-portieri i Realit.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

Ref. nr. 2340/20

Pejë, 18.11.2020

Me bazë në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, UA nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës nr. 04/L-037, nenin 169, 170, 171, 172, 173, 174, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 04-V-622, Rregulloren për të Ardhurat Personale të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë ref. nr. 1944/16, e dt. 05.10.2016, Rregulloren për Procedurat Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nr. 754, dt. 01.04.2019, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë 17.11.2020, nxjerri vendim sipas të cilit:

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" në Pejë  
shpall

### K O N K U R S

për riemërimin/avancimin e personelit akademik të rregullt në UHZ

#### I. Konkursi për shpalljen e pozitave në vijim:

##### FAKULTETI JURIDIK

1. Një mësimdhënës për lëndët: E drejta Ndërkombëtare e Punës, E Drejta Biznesore dhe të Drejtat e Njeriut, E Drejta Ndërkombëtare Private Konvencionale;

##### FAKULTETI I MENAXHIMIT NË TURIZËM, HOTELERI DHE MJEDIS

1. Një mësimdhënës për lëndet: Organizimi dhe Menaxhimi i Ngjarjeve, Mjedisi i Biznesit në Turizëm, Turizmi Ndërkombëtar, Trashëgimia Kulturore;

##### FAKULTETI I AGROBIZNESIT

1. Një mësimdhënës për lëndët: Biologji (TU), Mikrobiologji Bujqësore (TPB), Mikrobiologji (A&A);

##### KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Riemërimi/avancimi i personelit akademik do të bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, dispozitat e Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, si dhe Rregulloren për Procedurat Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nr. 754, dt. 01.04.2019.

#### II. KUSHTET PËR APLIKIM:

